


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.467/2022

Datë: 08 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 85, paragrafi 15, nenit 103 paragrafi 4 dhe nenit 104 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3, nenit 26 dhe 30 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, përmes komunikimit elektronik me datë 8 dhjetor 2022, merr këtë:

V E N D I M


- I. Z. Enver Peci, gjyqtar dhe Kryetar i Gjykatës Supreme të Kosovës, propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për lirim nga detyra e gjyqtarit dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 08 dhjetor 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 7 dhjetor 2022, ka pranuar një shkresë nga Kryetari i Gjykatës Supreme z. Enver Peci, me kërkesë për miratimin e dorëheqjes nga pozita e gjyqtarit dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme, për shkak të votimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës për emërim gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

Këshilli, pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit Peci, ka miratuar dorëheqjen e tij nga ushtrimi i funksionit të kryetarit dhe gjyqtarit të Gjykatës Supreme. Prandaj, Këshilli Gjyqësor, konform nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i propozon Presidentes së Republikës së Kosovës Sh.S.Znj. Vjosa Osmani Sadriu, që të nxjerr dekret për lirim nga detyra e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të z. Enver Peci. Nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit.